

VENDIM NR.2
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË “ALB TECH PLAST” SHPK

Sot, më datë 30.12.2021 në orën 11:00, në selinë e Shoqërisë “Alb Tech Plast” Shpk, sipas njoftimit për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Alb Tech Plast” Shpk, mbi bazën e kërkesës të Ortakut Edurim Teqja me objekt vlerësimin e veprimtarisë dhe përjashtimin e Ortakut Petro Pina, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Alb Tech Plast” Shpk, person juridik shqiptar, e themeluar dhe e regjistruar rregullisht sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendër Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 25/01/2013, me Numër Unik Identifikimi të Subjektit (NUIS) L38725101G, dhe me Seli në adresën; *Elbasan-Peqin, Autostrada Peqin Elbasan, prane pishave, ne afersi te lumit Shkumbin*, përfaqësuar ligjërisht nga Administratori z. Evaldo Teqja., për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës si vijon;

1. Vlerësimin e veprimtarisë së Ortakut Petro Pina.
2. Përjashtimi i Ortakut Petro Pina nga Shoqëria “Alb Tech Plast” Shpk.
3. Të ndryshme në zbatim dhe në varësi të vendimarrjes lidhur me përjashtimin e Ortakut Petro Pina.

Janë të pranishëm të dy ortakët e shoqërisë si vijon;

Ortaku Edurim Teqja, atësia Agim, amësia Melqe, shtetas Shqiptar, lindur në Peqin, Elbasan dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. Personal G80507087P.

Ortaku Petro Pina, atësia Ligor, amësia Kleopatra, shtetas Shqiptar, lindur në Ndertan, Gjirokastrë dhe banues në Vlorë madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. Personal F302160980, përfaqësuar nga **Av. Andi Skënderi**, me nr 8514 Licence, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe **Av. Alban Alimema**, me nr 4256 Licence, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

Si dhe **Av. Aldo Shkëmbi** me nr. 7137 Licence Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, Përfaqësues Ligjor i Shoqërisë “Alb Tech Plast” Sh.p.k.

Pas diskutimit mbi çështjet e rendit të ditës dhe pas votimit nga Ortaku me të drejtë vote z.Edurim Teqja, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, me shumicë të thjeshtë-të zakonshme (duke votuar vetëm Ortaku Edurim Teqja pasi Ortaku Petro Pina nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës lidhur me çështjet e shtruara për diskutimin sipas parashikimeve të Nenit 89 i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, sipas të cilit; 1. *Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria*),

VENDOSI:

1. Përjashtimin e Ortakut Petro Pina nga Shoqëria “Alb Tech Plast” Shpk.
2. Emërimin e përfaqësuesit ligjor **Av. Aldo Shkëmbi** me nr.7137 Licence, Anëtarë i Dhomës së Avokatisë Tiranë, për të përfaqësuar Shoqërinë “Alb Tech Plast” Shpk duke ngritur padi në gjykatë për përjashtimin e Ortakut Petro Pina.

Mbi bazën e vendimit të marr në këtë mbledhje asambleje, nga ana e Kryetarit të Asamblesë/Administratorit, do të ndiqen të gjitha procedurat ligjore të parashikuara nga Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, ku i gjithë dokumentacioni i nevojshëm do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllim për tu reflektuar vendimarrja në Esktraktin e Shoqërisë.

ORTAKU
I SHOQËRISË “ALB TECH PLAST” SHPK
ME TË DREJTË VOTE
EDURIM TEQJA

Eduarim Teqja


